

V E N D I M

Nr. _____ Datë ____/____/ 2012

Mbi

Një ndryshim në Planin e Biznesit Ekonomiko Financiar të APD për vitin 2012

Këshill Drejtues, në mbledhjen e tij të datës 15.10.2012, pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Drejtoria Ekzekutive, mbështetur në :

Ligji nr 9130 datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual” neni 15 dhe neni 18 pika d;

V.K.M. Nr. 596 datë. 10.09.2004 “ Për Miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij” neni 9 pika 1, neni 10 pika d;

Vendimin e Këshillit Drejtues nr 27 datë 15.12.2011 “Për miratimin e planit të biznesit ekonomik financiar të APD-së për vitin 2012”;

Vendimin e Këshillit Drejtues nr 24 datë 15.03.2006 “Mbi miratimin e Rregullores së Këshillit Drejtues të APD-së” neni 16;

Me qëllim ndryshimit të planit të Biznesit Ekonomiko Financiar të APD për vitin 2012 :

V e n d o s i:

1. Miratimin e ndryshimit të zërave në planin e Biznesit Ekonomiko Financiar të APD për vitin 2012, miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr 27 datë 15.12.20012, ndryshuar me vendimin nr 46 datë 20.04.2012 si më poshtë :

Ne zërin investime shtohen këto zëra:

Zëra investime		Totali	Realizimi 2012
Ndërtim Montim	Rrethimi përgjatë realizimit të rrugës së re “Hyrja 4-Terminali I Trageteve	31,000,000	28,000,000
Makineri Pajisje	Paketën elektronike të el/vinvi 10ton	37,840,000	37,840,000
	Furnizimi me energji i Kalates nr 10	17,000,000	12,000,000
Investime për sistemin informatik dhe pajisje zyre	Zgjerimi i sistemit ISPS dhe check-in për Portën Nr. 4	70,000,000	30,000,000

1.1 Realizimi për vitin 2012 i zërave të investimeve sipas pikës 1.1 do të perballohet nga:

Kursime në zërin investim Ndërtim Montime:

Pika 9 , Përshatja e Kalatës 11, ngritja e kuotës së saj barazuar me rrafshin e kalatës nr. 10, mos realizimi për vitin 2012 të punimeve duke rialokuar fondin prej 30.000.000 në zërin “Rrethimi përgjatë rruges së Re Hyraj Nr.4 –Terminali i Trageteve”

Pika 10, “Ndertim i rrjetit të ujesjellesit në APD” kursimi i fondit të ndertimit të ujesjellesit në masen 8.000.000 leke duke bërë rialokimin në zërin

Kursime në zërin Investime për sistemin informatik dhe pajisje zyre:

Pika 9) Ndërtimi i hartave kadastrale të APD-se, të përditësuara dhe Administrimi i ndërtesave me vlerë 10.500.000

Pika 12) realizimi i dhomës së dytë të serverave me vlerë 34.000.000 lekë

Pika 13) përmirësimi i dhomës primare të serverave me vlerë 14.000.000 lekë

Pika 14) Përmirësime të sistemit të informacionit me vlerë 13.040.000 lekë

1.2 Në zërin shpenzime, miratohet rialokimi i fondeve për gjelbërimin e rrugës së re Porta Nr.4 Terminali i Trageteve, me vlerë 18.000.000 leke.

Fondet për këtë shpenzim do të perballohen nga kursimi i zërit shpenzime , Pika 21) Pjesë këmbimi (mekanike, elektrike, elektronike, informatike etj.)

2. Ngarkohet Drejtoria Ekzekutive e APD-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARE

Iva CARA

KRYETARI

Ervin MINAROLLI

Anëtarët

Mirela HASANAJ

Genc MATAJ

Ylli DYLGJERI

Adrian ÇELA

Agim MAKSUTI